



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 449/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaçi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur lidhur me apelin e Valon Ramadani kandidat për deputet, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuar nga KQZ-ja me datë 07.11.2019, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me datën 06 tetor 2019, në seancën e mbajtur me 09.11.2019, mori këtë:

### VENDIM

**KONSTATOHET** tërheqja e apelit A.nr.449/2019 e datës 07.11.2019, e parashtuar nga Valon Ramadani kandidat për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

### Arsyetim

Kandidati për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Valon Ramadani nga Ferizaj me datën 07.11.2019 ka paraqitur apel në PZAP, Anr.449/2019, i cili ka kërkuar që të hapet për rinumërim kutia me numër 2501D/07R, ngase ka dyshime të bazuara se në vendvotimin e lartë përmendur numri i qytetarëve të cilët e kanë votuar është më i madh se numri i votave të përshkruara në FRP. Parashtruesi i apelit me tutje thekson se në Qendrën e Votimit Shkolla “Tefik Çanga”, në çdo vendvotim kam vota me shumë se sa numri 21 në listën e deputetëve të LVV-së, të cilat vota janë bartur me ose pa qellim të kandidatit me numër 21, si dhe ka kërkuar nga PZAP që në përputhje me legjislacionin zgjedhor në fuqi të numëroj votat në vendvotimin 2501D/07R, me qellim që të eliminohet gabimi teknik në fjalë.

Me datë 08.11.2019, ankuesi ka parashtuar kërkesën me nr. Protokollit 449/2 për tërheqjen e apelit Anr.449/2019, të datës 07.11.2019, për rinumërimin e vendvotimit 2501D/07R.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e apelit, në kuptim të nenit 11 paragrafi 2 të Rregullën Nr.02/2015 të PZAP-it si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.449 /2019 më datën 09.11.2019

Kryesuese e Panelit  
Rrustem Thaçi

